



Hapet thirrja për mobilitet (bursë) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+ në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursë për mobilitet për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentin:

- Studenti duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike. (Student, viti i I Master).

Kohëzgjatja e bursës:

- 4 muaj, 1 tetor 2023 – 14 shkurt 2024

Fusha e studimit: Inxhinieri Elektrike (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike).

- Electrical Engineering (*MHB_MET_EN_03-2023_reading_assist.pdf*)

Numri total i studentëve: **1**

Duke u inkurajuar edhe nga politikat sociale të Anhalt University of Applied Sciences, përparësi do të kenë studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët me probleme sociale.

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli i kërkuar është nga B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit. në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*



Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’, ju lutemi klikoni në link-un:
[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t’u njohur me programet e lëndëve, ju lutemi klikoni në link-un:
FAQ Incoming: <https://www.hs-anhalt.de/en/international/studyexchange-and-internship-abroad/erasmus/incoming-students.html>

Afati për aplikim: Deri më 5 maj 2023, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al .